

Parathin

Poezia – pasqyrë e shpirtit që bën pyetje!

Moshë mistike. Ky është titulli i vëllimit me poezitë frymëzuara që po na ofron poeti i madh kosovar Jeton Kelmendi. Ne gjejmë, nëse futemi në thellësi rrezet e një projekcioni të ri të temave të mëdha që na i ka parashtruar edhe në vëllimet e mëparshme.

Që nga fillimet e aktiviteteve të tij letrare, Jeton Kelmendi është ilustruar në gjini të ndryshme, thënë ndryshe në Dramaturgji me drama “Zonja fjalë”, gjithashtu dhe me “ese politike”, por zemra e punës së tij është Poezia. Nëpërmjet aj ai shpreh ndjenjat dhe mendimet rreth atdheut, relacion dashuror me tokën, lidhjet e tij të thella me bashkëkombësit.

Ky vëllim grupon poezi të shkruar në vitin 1999, fillimin e angazhimi të tij si ushtar në luftën për tokën e tij Kosovare, deri në qershorin e vitit 2013, në datën e vdekjes së babait të ti. Megjithëse kjo nuk shfaqet hapur në poezinë e tij, e gjejmë në to një kronologji kohore si kompozicion. Këto dy data të piketuara formojnë në të vërtetë një Globus fati. Fillimi e një jete madhore për një burrë, simbolizuar nga dashuria e parë dhe impenjimi i parë për lirinë, që nënkupton fundin përfundimtar të fëmijërisë, të shënuar nga fakti se nuk do të këtë kurrë më gjenerata që do ta pasojnë në këtë aventurë jetësore.

Jeton Kelmendi na zbulon në këtë hyrje në “moshë madhore” mbi të gjitha impenjimin e tij koherent brenda poezive të njëpasnjëshme. Vëllimi nis me poemën e admirueshme “Peja në Orën pesë të mëngjesit”, ku kam zbuluar vargje që përfundonin me klithmën poetik: “O pranverë, sezon plot shkëlqim,/ti transporton sensacionet përtej retorikave,/por këtë herë,/ti more babain tim,/sigurisht ne jetojmë me praninë e tij/me shumë kujtime dhe me shumë mallëngjime, / gjithçka do të bëhet edhe më e solemne, / s’do të jetë dikush që do të japë këshilla,/sepse ti baba nuk je më me ne...”

Pikërisht në këtë varg të fundit, kam zbuluar idenë të hyrjes definitive, pa shpresa rikthimi, në një botë ku ne jemi përgjegjës për gjithçka, ku askush nuk mund të vendosë në vendin tënd. Por rruga drejt kësaj bote kishte nisur shumë kohë më parë, siç na e ilustron poema, “Dashuri

në kohërat e luftës”. Kjo poemë që na vë në evidencë hyrjen në moshën madhore të poetit, të angazhimit të tij të parë për atdheun, do të na e bëjë me dije dy dashuritë, ajo për atdheun dhe ajo për femrën, jo vetëm që janë të pranueshme njëra me tjetrën, por janë të shkruara si dy dashuri organike.

Çuditërisht, edhe në betejat më të ashpra, një ushtar nuk pushon së menduari për dashurinë. E di një gjë të tillë pasi e kam përjetuar edhe vetë. Nga kjo eksperiencë e jetuar, poeti tenton të bëjë një pajtim me dashurisë dhe luftës. Lufta dhe dashuria gërshetohen mes tyre, duke rritur gjenetikisht njëra tjetrën. Bashkimi i tyre intim e bën njeriun më të mirë teksa lufton për kauzën e tij...sepse përtej të qenurit i shoqëruar nga idhtarë të së njëjtës kauzë, do të ndajë në fund kënaqësinë e fitores dhe dëlirin e lirisë.

Natyrisht, nuk duhet patur iluzion. Sigurisht, Lufta është edhe fundi i dashurisë më të bukur, por poeti mbart ë shpirtin e tij shpresat, sepse ai i di që: Dashuritë më të pasionuara,/ lindin në kohërat e luftërave, / ndoshta,/ ndoshta ato, / ua kalojnë edhe vargjeve biblike,/ose historive më të famshme të kohërave...

Dashuri, miqësi, shoqëri mistike, të gjitha këto ndjenja fisnike janë të evokuara me flaut magjik në këtë vëllim. Por këtu, me gjithë eksperiencën dhe kujtimet në aksione lirie të autorit, janë tek e fundit hapja e një perspektive më frymëmarrje më të madhe në hapësirë. Kemi shtrim pyetjesh mbi çështje kryesore, si ekzistenca, roli i poetit , roli i fjalës dhe i heshtjes, mbi rëndësinë e gjesteve të trimërisë, rëndësinë e angazhimit të fortë dhe pa ekuivokë, sigurisht në heshtje, pa mburrje:

Sikur edhe njëri të na fliste për heshtje ,/Sikurse zoti flet për ujët...

Të gjitha këtë pyetje qëndrojnë të pandashme me hapin e parë, për dashurinë dhe për atdheun, sepse vetëm një shpirt i ndjeshëm, mund të penetrojë në rëndësinë e tyre, mund të gjejë frymëmarrjen dhe fjalët që duhen shkrimit të një poezie të vërtetë, të aftë të transkriptojë shkrimet e padukshme të botës.

Akad. Athanase Vantchev de Thracy,

Paris Gusht 2018...

Përktheu nga Frëngjishtja: Albert Nikolla

Préface

La poésie, miroir de l'âme qui s'interroge

L'âge mystique. Tel est le titre du nouveau recueil de poésies inspirées que vient de nous offrir le grand poète kosovar Jeton Kelmendi. On y retrouve, approfondis, envisagés sous un nouvel angle de vision, les grands thèmes de ses précédents recueils.

Depuis le début de son activité littéraire, Jeton Kelmendi s'est illustré dans divers genres, dont par exemple la dramaturgie, avec sa pièce *Dame Parole*, ainsi que les essais politiques, mais le cœur de son travail reste la poésie. C'est par elle qu'il exprime le mieux ses sentiments d'appartenance à sa patrie, sa relation charnelle à sa terre, son attachement profond à ses compatriotes.

Ce recueil regroupe des poésies dont l'écriture va de 1999, début de son engagement de soldat dans sa lutte pour sa terre kosovare, à juin 2013, date de la mort de son père. Même si les poèmes ne sont pas, dans le recueil, dans l'ordre de leur composition, ces deux dates butoirs forment une sorte de bulle du destin. Le début de la vie adulte d'un homme, symbolisé par le premier amour et le premier engagement pour la liberté, et la vraie fin de l'enfance, marquée par le fait qu'il n'y a plus de génération qui le précède.

Jeton Kelmendi nous développe cette entrée dans la maturité et l'accomplissement de soi dans cette suite de poèmes.

Le recueil débute donc par l'admirable poème : ***Pejë à cinq heures du matin***, où j'ai recueilli les vers qui le terminent :

Ô Printemps,

saison splendide,

Tu emportes les sens au-delà de la rhétorique,

Mais cette fois-ci tu as emporté

Mon père,

Désormais nous vivrons avec plus d'ardeur,

Plus de mémoire, plus de fables,

Tout sera désormais multiplié,

Pourtant personne ne me portera plus conseil

Car mon père n'est plus avec nous.

C'est dans ces derniers vers que se trouve l'idée de l'entrée définitive, sans espoir de retour, dans un monde où l'on est responsable de tout, où personne ne peut rien décider à votre place. Mais le chemin vers ce monde avait déjà commencé bien avant, comme l'illustre le troisième poème, *Amour en temps de guerre*. Ce poème, qui rend compte de l'entrée dans l'âge adulte

du poète, de son premier engagement pour sa patrie, veut montrer que celui-ci et l'amour ne sont pas incompatibles, et que :

Pourtant même dans les combats les plus violents

Un soldat ne cesse de penser à son amour,

Je le sais, l'ayant éprouvé moi-même.

Par cette expérience vécue, le poète nous confie sa démarche, qui est de viser à réconcilier l'amour et la lutte. La lutte et l'amour se transcendent l'un l'autre, s'appuient, se grandissent. Leur union intime rend l'homme meilleur combattant pour sa cause, car il a la certitude qu'au-delà de ses compagnons, il aura une compagne avec qui il partagera le bonheur de la victoire.

Bien que sans illusion, sachant que la guerre met trop souvent fin aux plus belles amours, le poète garde espoir, car il sait aussi que :

... les amours les plus passionnées

Naissent en temps de guerre.

Peut-être,

Peut-être qu'elles surpassent même

Le récit biblique

Ou même les histoires les plus illustres.

Amours, amitiés, camaraderies de luttés, tous ces nobles sentiments sont évoqués avec brio dans ce recueil. Mais celui-ci, même si l'expérience et les souvenirs du combattant de la liberté de l'auteur en sont la base, s'ouvre sur des perspectives plus larges. Il aborde des questions existentielles, s'interroge sur le rôle du poète, sur celui de la parole et du silence, sur l'importance des gestes esquissés, sur l'engagement silencieux :

Si seulement quelqu'un parlait du silence

Comme Dieu parle des étoiles...

Mais toutes ces interrogations restent corrélées à sa démarche première, à l'amour et à la patrie, car seule une âme sensible, pénétrée de leur importance, peut trouver le souffle et les mots qui font de son écriture une poésie vraie capable de transmuter et d'exprimer le monde.

Acad. Athanase Vantchev de Thracy

Paris, août 2018